



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit

S- 027

Prishtinë, më 13 qershor 2008, në orën 17:30

Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
13 QERSHOR 2008

Seancën e kryesoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryesuesi konstatoi se në seancë janë të pranishëm 77 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesuesi njoftoi deputetët se në bazë të Vendimit të Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin lidhur me të, sipas procedurës së veçantë, datë 15 shkurt 2008, seanca e sotme plenare do të zhvillojë punimet me këtë

R e n d d i t e:

I. Shqyrtimi i dytë i Grupit të pestë të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit, sipas procedurës së veçantë:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale,

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Fondin pensional të Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/2 për themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Mineralet në Kosovë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, të kanalizimit dhe të mbeturinave,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2003/16 për shpalljen e Ligjit për Telekomunikacion, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit nr. 2004/9 për Rregullatorin e Energjisë, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndërmarrjet publike,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2008/13 për miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën 1 janar deri me 31 dhjetor 2008, dhe
11. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin e 7 ligjeve, në pjesën e hyrjes në fuqi.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Komisionit ad-hoc që para deputetëve të Kuvendit t'i arsyetojë rekomandimet për këtë projektligj.

Deputeti **Fehmi Mujota** tha se Komisioni ad-hoc, në bazë të vendimit të Kuvendit të Kosovës, datë 15 shkurt 2008, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2008, ka shqyrtuar grupin e pestë të projektligjeve të miratuara në seancën e mëparshme dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Komisioni, pasi shqyrtoi Projektligjin për shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, njëzëri vendosi t'i rekomandojë Kuvendit ta miratojë Projektligjin në formën e propozuar.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 56;
Kundër----- 3.
Abstenime-----12.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni ad hoc ka shqyrtuar Projektligjin për shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë atë në formën e propozuar.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 71;
Kundër----- 1.
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni ad hoc ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë atë në formën e propozuar.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 71;
Kundër----- 1.
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Fondin pensional të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni ad hoc ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Fondin pensional të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë atë në formën e propozuar.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 71;
Kundër----- 3.
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Fondin pensional të Kosovës.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/2 për themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Mineralet në Kosovë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni ad hoc ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/2 për themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Mineralet në Kosovë dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë atë në formën e propozuar.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 66;
Kundër----- 1.
Abstenime-----7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/2 për themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Mineralet në Kosovë.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, të kanalizimit dhe të mbeturinave

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni ad hoc ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, të kanalizimit dhe të mbeturinave dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë atë në formën e propozuar.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 70;
Kundër----- 1.
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, të kanalizimit dhe të mbeturinave.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2003/16 për shpalljen e Ligjit për Telekomunikacion, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës

Kryesuesi ftoi kryesuesin e Komisionit ad-hoc, **Fehmi Mujota**, t'i arsyetojë rekomandimet për këtë projektligj.

Fehmi Mujota tha se Komisioni ad-hoc, në bazë të vendimit të Kuvendit të Kosovës, datë 15 shkurt 2008, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2008, ka shqyrtuar propozimet e parashtruara nga ministri për Transport dhe Post-Telekomunikacion, Fatmir Limaj, që në nenin 11, ku Ministria autorizohet të lidhë marrëveshje bilaterale dhe multilaterale me organizata ndërkombëtare në fushën e telekomunikacionit dhe, po ashtu, neni 13 ka pasur propozim që të fshihet dhe të ngel ashtu si është në nenin 19. Kjo është aprovuar në seancë, në parim, ndërsa sot Komisioni ad-hoc në shqyrtim nuk i ka pasur 2/3 e votave për t'i aprovuar këto ndryshime që janë aprovuar dje në seancën plenare, në parim. Arsyetimi ishte që një pjesë e saj është e rregulluar me Kushtetutën e Kosovës, kurse pjesa tjetër me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe në seancë duhet të votohet për pikën 2.

Lidhur me këtë debatuan: Ardian Gjini, Lutfi Haziri dhe Lulzim Zeneli, diskutimet e të cilëve janë pjesë përbërëse e Transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** hodhi në votim miratimin e këtij Projektligji me mocionin e Komisionit Ad - hoc. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 37;
Kundër-----34.
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2003/16 për shpalljen e Ligjit për Telekomunikacion.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit nr. 2004/9 për Rregullatorin e energjisë, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni ad hoc ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin e Ligjit nr. 2004/9 për Rregullatorin e Energjisë dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë atë në formën e propozuar.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60;
Kundër----- 3.
Abstenime-----6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin e Ligjit nr. 2004/9 për Rregullatorin e Energjisë.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndërmarrjet publike

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni ad hoc ka shqyrtuar Projektligjin për ndërmarrjet publike, dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë atë me një amendament.

Kryesuesi hodhi në votim amendamentin e propozuar nga Komisioni ad-hoc në Projektligjin për ndërmarrjet publike.

Kuvendi, me shumicë votash, miratoi amendamentin: 1.

Pastaj, **kryesuesi** e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentin e miratuar. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 58;
Kundër----- 4.
Abstenime-----8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndërmarrjet publike.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2008/13 për miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuar për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2008

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni ad hoc ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2008/13 për miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuar për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2008 dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë atë me një amendament.

Kryesuesi hodhi në votim amendamentin e propozuar nga Komisioni ad-hoc në këtë projektligj.

Kuvendi, me shumicë votash, miratoi amendamentin: 1.

Pastaj, **kryesuesi** e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentin e miratuar. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59;

Kundër-----1;

Abstenime-----9.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2008/13 për miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuar për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2008

11. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin e 7 ligjeve, në pjesën e hyrjes në fuqi

Kryesuesi i njoftoi deputetët me propozimin e Qeverisë për ndryshimin dhe plotësimin e shtatë projektligjeve që kanë të bëjnë me dispozitën e hyrjes së tyre në fuqi, ku thuhet: ” Këto ligje hyjnë në fuqi ditën e publikimit të tyre në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës”.

Kryesuesi e hodhi në votim këtë projektligj. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----69;

Kundër-----1;

Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kufijtë administrativ komunal, të ligjit për Agjencinë e Privatizimit, të ligjit për arsimin në komunat e republikës së Kosovës, të ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, të ligjit për Agjencinë e Inteligjencës së Kosovës, të ligjit për azil dhe të ligjit për menaxhimin dhe kontrollin e integruar të kufijve.

Në dispozitën e hyrjes në fuqi të secilit ligj të cekur më lart, të shtohet teksti, si vijon: **“Ky Ligj hyn në fuqi ditën e publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës”.**

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 18:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale